

“Promovimi i Lirisë së Shprehjes në Shqipëri përmes Dialogut të Hapur”

Projekt dy-vjeçar i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i bashkë-financuar dhe zbatuar nga Këshilli i Evropës në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit të Universitetit të Tiranës.

Cili është qëllimi?

Projekti synon të forcojë lirinë e shprehjes në Shqipëri përmes një dialogu të hapur dhe efektiv ndërmjet institucioneve publike dhe aktorëve të medias, në linjë me standardet evropiane.

Kush përfiton nga projekti?

- Gazetarët dhe organizatat e mediave.
- Kanalet mediatike të sektorëve audioviziv, shtypit të shkruar dhe online
- Institucionet shtetërore përkatëse dhe autoritetet publike të pavarura.
- Organet rregullatore si RTSH (transmetuesi publik) dhe AMA (Autoriteti rregullator i medias).
- Ekspertët ligjorë, akademikët dhe hulumtuesit.
- Organizatat e shoqërisë civile të cilat advokojnë për lirinë e medias dhe transparencën.

Si do të funksionojë projekti?

Aktivitetet e projektit do të organizohen rreth një platforme të dialogut të strukturuar që përfshin autoritetet publike, aktorët e medias dhe organizatat e shoqërisë civile, në përputhje me angazhimet e Shqipërisë lidhur me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias, në kontekstin e procesit të integritetit në BE.

Platforma do të fokusohet në këto tema kryesore:

- Pronësia e mediave dhe gazetaria e pavarur
- Siguria e gazetarëve dhe shkeljet e lirisë së shtypit
- Qasja/Aksesi në informacion

Platforma do të strukturohet për të maksimalizuar angazhimin e palëve të interesuara dhe për të siguruar diskutime të bazuara në fakte. Metodologjia do të përfshijë elementët e mëposhtëm:

- Përfshirja e palëve të interesit
- Panele tematike dhe tryeza diskutimi
- Shkëmbimi i njohurive dhe ngritja e kapaciteteve
- Raportimi dhe zhvillimi i rekomandimeve specifike
- Transparenca dhe angazhimi publik

Departamenti i Gazetarisë dhe Komunikimit i Universitetit të Tiranës do të shërbejë si lehtësues nga perspektiva e përmbajtjes, si dhe nga ajo organizative. Projekti do të përfitojë nga konsulentë/ekspertë të kualifikuar vendas dhe ndërkombëtarë për të udhëhequr grupet e punës dhe diskutimet plenare, si dhe për të formuluar masat e identifikuar bazuar në praktikën më të mirë evropiane.

Çfarë presim të arrijmë?

Institucionalizimi i një kuadri të strukturuar dhe të qëndrueshëm dialogu që mundëson autoritetet publike, aktorët e medias dhe shoqërinë civile të përparojnë së bashku lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias.

- Përmirësimi i kuadrit rregullator të medias dhe masave të lidhura me agjendën e integritetit në BE në përputhje me standardet evropiane.

Kohëzgjatja dhe buxheti:

Projekti do të implementohet nga janari 2025 deri në dhjetor 2026.

Buxheti total i projektit është 167,000 euro.